

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

LIGJËRATË INAUGURUESE

Profesor dr. Oliver Jens Schmitt

BALLKANOLOGJIA
SI DETYRË SHKENCORE

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
Rruga "Agim Ramadani" p.n.
10 000, Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel.: +381 38 249 303
ashak@ashak.org



Ligjërata mbahet të hënën, më 29 qershor 2015
në orën 12:00, në mjediset e Akademisë



PROFESOR DR. OLIVER JENS SCHMITT

Anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave të Austrisë dhe anëtar i jashtëm i ASHAK

Profesor dr. Oliver Jens Schmitt, profesor i historisë së Europës juglindore dhe drejtor i Institutit të Europës Lindore të Universitetit të Vjenës, anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave të Austrisë, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut, ka lindur në Bazel më 1973. Me formim për gjuhët klasike vijoi studime të larta në Basel, në Vjenë, në Berlin dhe në Mynih. U diplomua në Vjenë, ndërsa në vitin 2000 mbrojti doktoratën në Universitetin LMU në Mynih. Ndoqi studime të specializuara në Romë e Venecie, dha mësimë në Institutin e Historisë së Europës Lindore dhe Juglindore më Universitetin e Mynihut. Pas Habilitimit për histori të Europës Lindore dhe Juglindore në Universitetin e Regensburgut (2003), qe profesor i historisë në Universitetin e Bernës, ndërsa nga 2005 Profesor ordinar për Histori të Europës Juglindore në Universitetin e Vjenës. Më 2009 u zgjodh anëtar korrespondent, ndërsa më 2011 anëtar i rregullt i Akademisë Austriake të Shkencave. Në vitin 2013 u zgjodh anëtar i jashtëm i ASHAK.

Profesor Schmitt ka qenë Anëtar i Drejtorisë së Kurisë së të Rinjve të Akademisë Austriake të Shkencave, është Kryetar i fondacionit të Südost-Institut, Regensburg; Anëtar i Balkan-Kommission të Akademisë Austriake; Anëtar i Komisionit për histori i Fondacionit Pro Oriente; Anëtar i Këshillit Shkencor të Qendrës Studimore Gjermane në Venecie; bashkëredaktor i Südost-Forschungen; bashkëredaktor i Albanische Forschungen; bashkëredaktor i Cahiers Pierre Belon; bashkëredaktor i Mélanges d'histoire générale (Klausenburg/ Cluj).

Në Institutin e Studimeve të Europës Lindore të Vjenës ai kujdeset për Albanien-Institut bashkë me bibliotekën e trashëguar nga Albanien Institut i Mynihut, që ishte ngritur nga profesor dr. Peter Bartl.

Profesor dr. Oliver Schmitt parapëlqen kryesisht këto fusha: *Historia shoqërore dhe ekonomike në Mesjetë; Proceset e transformimit socio-ekonomik dhe kulturor në hapësirat në jug të Danubit në fund të shekullit 17; Hapësira kulturore veneciane në Europën Juglindore (rreth 1000-1797); Homogjenizimi socio-kulturor dhe hibridizimi në hapësirën mesdhetare (nga sh. 15 deri në sh. 20), Rrjet hulumtimi me Universitetet Bern dhe Genf; Hulumtime për historinë shqiptare (përfshirë Kosovën dhe Maqedoninë).*

Ka botuar *Das venezianische Albanien 1392- 1479*, München 2001, përkthyer shqip - *Arbria venedike 1392 – 1479* dhe botuar në Tiranë më 2007.

Levantiner - Lebenswelten und Identitäten einer ethnokonfessionellen Gemeinschaft im osmanischen Reich im "langen 19. Jahrhundert", München 2005, përkthyer turqisht (Istanbul 2007).

Njihet me monografinë *Kosova – Histori e shkurtër e një hapësire të Ballkanit Qendror (Kosovo - Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft)*, Wien 2008, përkthyer shqip nga Enver Robelli dhe botuar te Koha më 2012.

Ka botuar studime për historinë e Skënderbeut: *Skanderbegs letzte Jahre. West-östliches Wechselspiel von Diplomatie und Krieg im Zeitalter der osmanischen Eroberung Albaniens (1464-1468)*, Südost-Forschungen 62 (2004/2005), ff. 56-123; *Skanderbeg reitet wieder. Wiederfindung und Erfindung eines (National-)Helden im balkanischen und gesamteuropäischen Kontext (15-21 Jh.)*, në Festschrift für H. Sundhausen zum 65 Geburtstag, Berlin, 2007, ff. 201-419; *Venezianische Horizonte der Geschichte Südosteuropas*, në Südost-Forschungen 65/66 (2006/07), ff. 87-116; *Skanderbeg. Der neue Alexander auf dem Balkan*, Verlag Friedrich Pustet, 2009.

Libri i tij për Skënderbeun u botua shqip në Tiranë më 2008.

Më 2012, në shënim të 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, botoi te C. H. Beck, München librin *"Shqiptarët: një histori midis Lindjes dhe Perëndimit"* (*Die Albaner: Eine Geschichte zwischen Orient und Okzident*), ff. 183.

Bashkë me K. Klewing në vitin 2011 në Regensburg ka botuar veprën kolektive *Geschichte Südosteuropas. Vom Mittelalter bis zur Gegenwart*, ff. 837, për të cilën ka hartuar pjesë të mëdha dhe hyrjen e përfundimin bashkë me K. Klewing.